

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

## V E N D I M

Nr. 393, datë 29.6.2023

## PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.109,  
DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR  
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SIGURIMIT  
TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT  
TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE  
PËR PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN  
E LARTË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

## V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
  - a) Në fund të pikës 14 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në Bordin e Akreditimit merr pjesë edhe një student, në rolin e vëzhguesit, përfaqësues i Këshillit Kombëtar të Studentëve.”.
  - b) Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Mbledhja e Bordit të Akreditimit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 8 (tetë) anëtarë të tij. Vendimet e bordit merren me shumicë prej  $\frac{3}{4}$  të anëtarëve të pranishëm.”.
  - c) Pika 26 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“26. Kryetari dhe anëtarët e Bordit të Akreditimit paguhen për çdo pjesëmarrje në mbledhje. Për çdo vit kalendarik zhvillohen 12 (dymbëdhjetë) mbledhje. Nëse është e nevojshme, Bordi mund të mbledhet deri në 3 (tri) herë të tjera, brenda të njëjtit vit kalendarik, me kërkesë të ministrit përgjegjës për arsimin.”.

ç) Pika 27 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“27. Masa e shpërblimit për çdo mbledhje të jetë, si më poshtë vijon:

- a) Anëtarët me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;
- b) Anëtarët me rezidencë të përhershme jashtë Republikës së Shqipërisë, në masën 600 (gjashtëqind) euro;
- c) Kryetari, në varësi të rezidencës së tij të përhershme, në masën 30% më shumë se anëtarët e Bordit.”.

d) Në paragrafin e parë, të pikës 2, të shtojcës 2, bashkëlidhur vendimit, pas fjalëve “... në IAL-të publike ...” shtohen “... dhe jopublike ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**ED I R A M A**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTRI I ARSIMIT  
DHE SPORTIT**

**EVIS KUSHI**

NR.PROT. 2774/1  
DATË 29.6. 2023

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË  
ARSIMIN E LARTË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**



*Engjell Agaçi*